



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SHITËRPECËS PËR VITIN 2020

Prishtinë, qershor 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Bratislav Nikolic, Kryetar

Adresa: Shtërpcë, Shtërpcë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Shtërpcës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Shtërpcës (Komuna e Shtërpcës), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Shtërpcës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Shtërpcës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komuna e Shtërpcës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

- 1 Për vëmendjen tuaj, dëshirojmë të theksojmë faktin se Komuna kishte bërë pagesa nga kategoria e Mallrave dhe shërbimeve në shumë prej 19,765€. Kjo kishte ndodhur për arsyen se me rastin e aprovimit të Ligjit për ndarjet buxhetore të vitit 2020, këto shpenzime ishin planifikuar dhe ekzekutuar në kategori jo adekuate ekonomike dhe kanë rezultuar me keq klasifikim të shpenzimeve, duke mbivlerësuar shpenzimet në kategorinë e Mallrave dhe shërbimeve dhe duke i nënvlerësuar shpenzimet e Investimeve kapitale për të njëjtën shumë. Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Buxhetit të Kosovës, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Shtërpçës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Shtërpçës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Shtërpçës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Shtërpçës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë të mjaftueshme ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Shtërpçës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna në vitin 2020 ishin në vlerë 232,752€. Ato kanë të bëjnë me tatimin në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, etj. Komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat mbledhen nga niveli qendror në vlerë prej 52,875€ (gjobat në trafik 40,796€, gjobat nga Agjencia e pyjeve 10,404€, si dhe nga Gjykata 1,675€).

Çështja C1 - Mos verifikimi i gjendjes aktuale të pronave

Gjetja Sipas nenin 15 të pikës 2 të Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, përcaktohet që 'Veprimtaritë inspektuese të kryhen çdo vit për të paktën 20% të të gjitha objekteve brenda territorit të komunës'.

Nga 4,696 prona të evidentuara në bazën e të dhënave mbi tatimin në pronë, komuna kishte arritur të verifikoj 322 prej tyre apo 7%. Përkundër që nuk ishte arritur niveli i kërkuar i verifikimit prej 20%, kjo tregon për një performancë më të mirë se sa viti paraprak (verifikimi 2019 ishte 1%). Po ashtu, komuna kishte regjistruar edhe 166 prona të reja.

Verifikimi jo i plotë kishte ndodhur për shkak që zyrtarët komunal kishin pasur probleme me lëvizjet për shkak të pandemisë covid-19.

Ndikimi Verifikimi jo i plotë i pronave për qëllime të tatimit në pronë, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. Mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mos shpërndarja e faturave / aktvendimeve për taksën në biznes

Gjetja Sipas nenit 3 të Rregullores komunale për taksa, kërkohet që pas regjistrimit të veprimtarisë afariste përcaktohet shuma vjetore e taksës me aktvendim dhe i dorëzohet subjekteve afariste më së voni një muaj para fillimit të vitit kalendarik.

Komuna e Shtëpcës nuk kishte shpërndarë te bizneset aktvendimet / faturat për taksë në biznes as në vitin 2020 dhe nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim për zbatimin e rekomandimit të dhënë në auditimin paraprak.

Kjo gjendje vazhdon të jetë për shkak të neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi

Mosrespektimi i rregullores lidhur me shpërndarjen e faturave (aktvendimeve) për taksën në biznes ndikon direkt në uljen e të hyrave, gjë që rezulton në fonde më të vogla të Komunës për të arritur objektivat e planifikuara.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të siguroj që zyrtarët përgjegjës janë duke i kryer detyrat dhe përgjegjësitë në lidhje me faturimin e taksës së biznesit dhe dorëzimin e faturave/aktvendimeve te subjektet afariste.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C2 - Mangësi në menaxhimin e tatimit në pronë

Gjetja

Neni 12 i UA nr.03/2011 për mbledhjen e informatave dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesin përcakton se: "Zyrtari përgjegjës komunal për tatimin në pronë duhet ti rishikoj të gjitha të dhënat, si dhe të bëjë verifikimin dhe konfirmimin e tyre".

Komuna nuk kishte bërë korrigjimin e gabimit në tatimin në pronë të identifikura në raportin e vitit të kaluar.

Sipas kartelës financiare në sistem, figuron se një tatimpagues ka paguar në emër të tatimit në pronë në vitin 2018 vlerën prej 4,323€. Në realitet këtu ka ndodhur një gabim në regjistrim sepse komuna nuk i ka pranuar këto mjete, pasi që realisht edhe tatimpaguesi nuk e kishte këtë borxh. Borxhi real i këtij tatimpaguesi për vitin 2020 kap shumen prej 8.16€, kurse sipas kartelës financiare tatimpaguesi ishte në parapagim në vlerë prej 4,293€.

Zyrtarët kanë deklaruar se kanë bërë kërkesë për korrigjimin e gabimit të lëshuar, por ende nuk janë bërë përmirësimet e nevojshme. Neve nuk na është ofruar dëshmi që është bërë një kërkesë e tillë.

Ndikimi

Vonesat në korrigjimin e kartelës financiare dhe faturës shkakton paqartësi në lidhje me gjendjen reale të borxheve të tatimpaguesit.

Rekomandimi C2

Kryetari duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës të komunës në bashkëpunim e me Ministrinë e Financave bëjnë rregullimet e gabimeve në bazën e të dhënave për tatim në pronë në pajtim me ligjet dhe rregulloret.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitetë

Buxheti final për mallrat dhe shërbime ishte 558,921€, prej tyre ishin shpenzuar 396,570€ apo 71% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet për telekomunikim, blerje të mobileve dhe pajisjeve, derivate dhe lëndë djegëse, shërbime të regjistrimit dhe sigurimit, mirëmbajtje, dhe shpenzimet tjera. Kemi testuar 15 mostra për teste substanciale në vlerë 113,877€ dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë në vlerë 103,215€.

Çështja A1 - Angazhimi me marrëveshje për shërbime të veçanta pa kryer procedurat ligjore

Gjetja Ligji për zyrtarët publik nr. 06/L-114 në neni 84 thekson se Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik

Komuna gjatë vitit 2020 kishte angazhuar pesë zyrtar me MSHV pa ndonjë procedurë. Ne analizuam tri (3) rastet e angazhimit pas hyrjes në fuqi të Ligji për zyrtarët publik, dhe verifikuam se kontratat ishin nënshkruar pa u zhvilluar ndonjë proces i prokurimit.

Komuna ka nënshkruar kontrata për shërbime të veçanta me:

- një përfaqësues ligjor me kohëzgjatje 3 mujore (4 shtator deri më 4 dhjetor 2020);
- një punëtor për pastrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike me kohëzgjatje 3 mujore (4 shtator deri më 4 dhjetor 2020); dhe
- një roje të pyjeve me kohëzgjatje 4 mujore (3 gusht deri 30 nëntor 2020).

Sipas menaxhmentit kjo ka ndodhur për shkak se komuna ka nevojë për këta punëtor dhe nuk ka të aprovuar punëtorë të mjaftueshëm për këto pozita.

Ndikimi Anashkalimi i procedurave të prokurimit në lidhje me mbulimin e pozitave me kontrata për shërbime të veçanta, përveç mosrespektimit të procedurave ligjore po ashtu e rrit edhe rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat për pozita të caktuara, çka mund të reflektoj edhe në performancë e tyre në punë.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar të jetë meritore në mënyrë që të jenë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 15,265,821€, pasurive jokapitale është 71,002€, si dhe e stoqeve 11,490€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 6,383,319€, si dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja C3 - Menaxhim jo i duhur i pasurive

Gjetja

Sipas nenit 2.1 të Rregullores 02/2013, të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik, me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

Ne identifikuam se:

- Gjatë testimit të një pagese për Pajisje speciale mjekësore në vlerë 151,793€ kemi vërejtur se pajisjet e blera nuk ishin në funksion por mbaheshin në depo. Gjatë ekzaminimit fizik dhe analizimit të regjistrit të pasurive vërejtëm se pajisje të blera mjekësore në vlerë 1,646,571€, mbahen në depo duke mos u përdorur, e që në anën tjetër vazhdojnë të zhvlerësohen. Zhvlerësimi i tyre deri në fund të vitit 2020 kishte arritur vlerën prej 786,182€. Për më tepër, kishte prej tyre pajisje në vlerën blerëse 52,290€ që ishin zhvlerësuar plotësisht dhe vlera e mbetur e tyre në regjistra kontabël është zero.
- Më tutje, komuna ka ndërtuar një Spital vlera e të cilit është 1,647,257€, pranimi teknik i të cilit është bërë me dt.31.10.2012 dhe i cili ende nuk është futur në përdorim edhe pse nga data e pranimit teknik ka filluar të zhvlerësohet. Zhvlerësimi i akumuluar i kësaj ndërtese deri në fund të vitit 2020 ka arritur në 336,295€ (20% e vlerës së objektit).
- Në regjistrin e pasurive të komunës janë të evidentuara katër ndërtesa banimi të ndërtuara dhe të destinuara për banorë me gjendje të rëndë sociale, me vlerë prej 2,709,075€. Edhe pse ndërtesat janë të përfunduara para më shumë se 5 viteve ato ende janë të pashfrytëzuara, nuk janë të pranuar teknikisht, mbahen si investime në vijim dhe nuk zhvlerësohen. Këto ndërtesa nuk shfrytëzohen nga askush, nuk kanë përkujdesje dhe nuk mirëmbahen. Nga vizita e realizuar kemi vërejtur se të gjitha këto ndërtesa kanë filluar edhe të dëmtohen dhe të vidhen pajisjet e instaluar të ndërtesave.

Sipas menaxhmentit ndërtesat nuk janë pranuar teknikisht për shkak të demolimeve dhe procesit të hetimit.

Ndikimi

Mbajtja e pajisjeve në depo për kohë të gjatë dhe mos funksionalizimi i tyre ndikon në zhvlerësimin e tyre ende pa u përdorur. Po ashtu, kjo ndikon edhe në dëmtimin fizik për shkak të kushteve të pa përshtatshme të ruajtjes së tyre dhe paraqet rrezik nga keq përdorimet dhe përvetësimet e paligjshme. Më tutje, mos pranimi teknik dhe menaxhimi i tillë i ndërtesave rritë rrezikun që ato të dëmtohen dhe të rritet kostoja e kthimit të tyre në gjendje për përdorim.

Rekomandimi C3 Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat për blerjen e pajisjeve dhe planifikimi i nevojave për prokurim të jenë analizuar mirë dhe në përputhje me krijimin e parakushteve për funksionalizimin e tyre, duke pasur parasysh gjithnjë vlerën për paranë. Më tutje, duhet të merren masa urgjente që të krijohen parakushtet që pajisjet që gjenden në depo dhe ndërtesat e banimit sociale të futen sa më shpejt në përdorim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C4 - Mos inventarizimi dhe vlerësimi i pasurive jo financiare

Gjetja Sipas neneve 18,19 dhe 21 të Rregullores për menaxhimin e pasurisë nr. 02/2013, kërkohet nga ZKA i Komunës që të themeloj Komisionin për Inventarizimin dhe vlerësimin e Pasurive jo Financiare.

ZKA ka themeluar komisionin për inventarizimin e pasurive dhe komisionin për vlerësimin e pasurive, por komisionet nuk ishin funksionalizuar dhe nuk e kishin kryer as inventarizimin e as vlerësimin e pasurive.

Menaxhmenti nuk ka dhënë ndonjë sqarim se pse nuk e kanë kryer punën këto komisione.

Ndikimi Mos inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë komunale në fund të vitit rritë rrezikun e mos zbulimit të dëmtimit, tjetërsimit apo humbjes së mundshme të pasurisë komunale. Kjo do të ndikoj që në fund të vitit Zyra e financave të mos ketë informatat e sakta për prezantimin e pasurive në PFV dhe që pasuritë të mbi apo nën vlerësohen.

Rekomandimi C4 Kryetari duhet të analizoj arsyet se pse nuk janë kryer veprimet e përcaktuara me vendim dhe të kërkoj përgjegjësi nga zyrtaret përgjegjës të emëruara në ato komisione në lidhje me inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive. Raporti i inventarizimit duhet të përgatitet para hartimit të PFV-ve me qëllim të krahasimeve dhe prezantimit të gjendjes reale të pasurisë komunale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 2,591,937€. Kjo vlerë përbehet nga Tatimi në pronë 2,372,557€ dhe Taksa vjetore të biznesit 219,380€. Llogaritë e arkëtueshme për dallim nga viti paraprak janë rritur për 259,854€.

Çështja B2 - Menaxhim jo i duhur i llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme me nenin 30 pika 1 është përcaktuar se nëse pas njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve kalendarike nga dita e fundit për pagesë, në përputhje me paragrafin 1. të nenit 27 të këtij Ligji, pagesa ende nuk është bërë, komuna merr vendim mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara që kanë kaluar shumën e treqind (300€). Vendimi merret brenda dhjetë (10) ditëve pune.

Sipas raportit të Ministrisë së Financave borxhet ndaj komunës për tatim në pronë krahasuar me vitin paraprak janë rritur për 255,904€[1]. Bazuar nga analizat tone figuron se deri në fund të vitit 2019 borxhi i tatimpaguesve që e kanë kaluar vlerën mbi 300€ është 1,432,230€. Pavarësisht kësaj, komuna nuk ka ndërmarr masa për arkëtimin e borxheve nga debitorët e saj. Vlen të përmendet se obliguesit më të mëdhenj nga Tatimi në Pronë (1,594,254 apo 65%) janë borxhe të ndërmarrjeve shoqërore të cilat janë në likuidim. Shuma e arkëtuar nga këto ndërmarrje në vitin 2020 ishte 63,267€, që përbën vetëm 4% të arkëtimit në raport me borxhin.

Sipas rregullores mbi taksat, tarifat dhe ndëshkimet komunale, neni 3, taksa për ushtrimin e veprimtarisë afariste, pika 3 i obligon subjektet afariste që të paguajnë të gjitha obligimet financiare nga vitet paraprake.

Komuna nuk kishte arritur të arkëtoj borxhet e viteve paraprake për taksa në biznes. Borxhet ndaj komunës për këtë taksë janë 219,380€ dhe janë më të larta për 3,950€ në krahasim me vitin e kaluar (215,430€).

Kjo kishte ndodhur për shkak se zyrtarët përgjegjës nuk kanë ndërmarrë hapat e përcaktuar në planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Ndikimi

Mos aplikimi i mekanizmave të përcaktuara me rregullore ndikon në rritje të vazhdueshme të këtyre llogarive, që rezulton me fonde më të vogla për arritjen e synimeve, dhe inkurajon debitorët e tjerë që të mos paguajnë detyrimet e tyre.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë dhe taksa në biznes, dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ^a	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	4,221,098	4,910,720	4,254,903	3,604,955	3,659,526
Grante Qeveritare - Buxheti	3,731,893	3,981,189	3,784,073	3,359,236	3,410,607
Financimi përmes huamarrjes	0	11,025	11,025	11,537	4,397
Të bartura nga viti i kaluar	0	398,159	312,228	106,215	123,079
Të hyrat vetanake	489,205	489,205	123,954	127,967	92,573
Donacionet e jashtme	0	31,142	23,624	0	28,871

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 689,622 €. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar për 398,159€, rritjes së grantit qeveritar për 133,410€, rritja e planifikimit për arkëtimin e të hyrave për 115,886€, pranimit të një donacioni prej 31,142€ dhe huasë prej 11,025€.

Në vitin 2020 Komuna ka shpenzuar 87% të buxhetit final ose 4,254,903€, me një ulje prej 2% në krahasim me vitin 2019. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit ishte në një nivel të kënaqshëm. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	4,221,098	4,910,720	4,254,903	3,604,955	3,659,526
Pagat dhe mëditjet	2,183,946	2,182,001	2,181,916	2,142,704	2,105,779
Mallrat dhe shërbimet	456,881	558,921	396,570	394,997	408,401
Komunalitë	88,625	88,625	64,385	71,859	81,278
Subvencionet dhe transferet	45,000	282,631	236,332	31,300	0
Investimet Kapitale	946,324	1,791,567	1,375,700	964,096	1,064,068
Rezervat	500,322	6,975	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me atë fillestar ishte më i ulët për 1,945€, ky buxhet ishte realizuar 100%. Përkundër realizimit të buxhetit, komuna kishte një planifikim të dobët buxhetor në raport me stafin e lejuar. Me ligj të buxhetit Komunës së Shtërpçës i janë lejuar 519 staf ndërsa në fund të vitit 2020 ishin 391 zyrtarë, përderisa në anën tjetër kemi shpenzimin e plotë të buxhetit të P&M.

Me ligjin e buxhetit Komunës ndër tjerash ju ishte lejuar 120 staf për shëndetësinë sekondare (Spitalin që nuk është funksionalizuar) për të cilët është ndarë një buxhet simbolik prej 209,575€ që nuk përputhet me vlerën reale të pagave të tyre. Në këtë sektor gjatë vitit 2020 ishin të angazhuar 23 punonjës, shpenzimi total për pagat e tyre ishte 143,902 apo rreth 70% e total buxhetit të shëndetësisë sekondare. Vlen të theksohet se 23 punonjësit janë rekrutuar si staf parapërgatitor për hapjen e spitalit, por që në fakt disa prej tyre punojnë në Komunë e të tjerët në QKMF- shëndetësinë primare. Nga analiza e buxhetit sipas BDMS -së nga formularët PSF-4 vërehet se komuna për këtë sektor ka planifikuar jo drejtë, duke vendosur tituj dhe grada si Kadet Policor me qëllimin e kalkulimit të koeficienteve më të ulët;


- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me atë fillesat ishte rritur për 102,040€, kjo rritje është rezultat i ndarjes së fondit për menaxhimin e pandemisë Covid-19 në vlerën 58,794€ dhe të hyrave të bartura nga viti i kaluar, në vlerë 43,245€. Sidoqoftë, shpenzimi i i buxhetit ishte 71% për shkak të mos ekzekutimit nga Thesari të pagesave të procesuara nga komuna para mbylljes së sistemit SIMFK në fund të vitit. Si rezultat i kësaj, niveli i detyrimeve të papaguara ishte i rëndësishëm (111,398€). Këto detyrime do të kenë një ndikim negativ në buxhetin komunal për vitin 2021 në këtë kategori;

- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me fillestarin është rritur për 237,631€ për menaxhimin e pandemisë Covid-19. Shuma prej 220,000€ për të financuar OJQ-të përmes një thirrje publike, lidhur me projektin "Programi i organizatave joqeveritare në fushën e zhvillimit ekonomik për tejkalimin e krizës ekonomike të shkaktuar me epideminë, me virusin Covid-19 dhe shuma prej 17,631€ nga të hyrat e bartura nga viti 2019; dhe


- Buxheti final për Investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar është rritur 845,243€. Përkundër një rritje të buxhetit të shpenzimeve kapitale vetëm 76% e buxhetit ishte shpenzuar. Për shkak të situatës me pandemi ka pasur vonesa në realizimin e projekteve kapitale, dhe rrjedhimisht edhe shpenzimet kanë qenë në raport me punët e kryera.

Komuna gjatë vitit 2020 kishte shpenzuar 313,444€ për menaxhimin e pandemisë Covid-19, prej tyre në kategorinë e pagave dhe mëditjeve janë shpenzuar 34,650€ për pagesën e shtesave në paga, 58,794€ në mallra dhe shërbime si dhe 220,000€ subvencione dhe transfere.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Të hyrat e realizuara nga Komuna në vitin 2020 ishin në vlerë 232,752€. Ato kanë të bëjnë me tatimin në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, etj. Komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat mblidhen nga niveli qendror në vlerë prej 52,875€ (gjjobat në trafik 40,796€, gjjobat nga Agjencia e pyjeve 10,404€, si dhe nga Gjykata 1,675€).

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	489,205	489,205	232,753	318,182	296,511
Të hyrat tatimore	337,181	337,181	169,995	182,612	137,670
Të hyrat jo tatimore	152,024	152,024	62,758	135,570	158,841

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të Komunës ka rezultuar në nëntë (9) rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Komuna ka përgatitur një raport të progresit në muajin tetor 2020, kurse raportin e dytë nuk e ka dorëzuar në ZKA. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, dy rekomandime janë zbatuar, një është mbyllur, katër pjesërisht të zbatuar dhe dy nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020


Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari të siguroj që zyrtaret përgjegjës janë duke i kryer detyrat dhe përgjegjësitë në lidhje ngarkesën e taksës së biznesit dhe dorëzimin e vendimeve të subjektet afariste.	Nuk janë ndërmarra veprime.	Nuk është adresuar

2.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës bëjnë rregullimet e gabimeve në bazën e të dhënave për tatim në pronë të në pajtim me ligjet dhe rregulloret.	Janë ndërmarrë veprime nga menaxhmenti për zbatimin e këtij rekomandimi pasi ka bërë kërkesë për korrigjimin e gabimit të lëshuar, por në sistem ende nuk janë bërë përmirësimet e nevojshme.	Pjesërisht i zbatuar
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se pajisjet futen në funksion dhe mbahen trajnimet për përdorim të programit si dhe inspektimi i objekteve për tatimit në pronë të bëhet sipas ligjit, në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës.	Përkundër që nuk është përmbytur plotësisht kërkesa ligjore ka një progres në raport me vitin paraprak. Në vitin 2019 ishin inspektuar 1% kurse në 2020 kemi 7%.	Pjesërisht i zbatuar
4.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se në të gjitha rastet për marrëveshjet për shërbime të veçanta të aplikohen procedura të thjeshtësuara të rekrutimit.	Legjislacioni ka pësuar ndryshime në mes të vitit dhe është trajtuar me legjislacionin e ri.	Nuk është i aplikueshëm më
5.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se përfituesit e subvencioneve raportojnë për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve sipas kriterëve të përcaktuara në marrëveshje, në të kundërtën të zbatohen kërkesat e marrëveshjes në rast të mos raportimit	Menaxhmenti ka ndërmarr masa në zbatimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se financimi nga huamarrja prezantohet në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.	Menaxhmenti ka ndërmarr masa në zbatimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar
7.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që zbatohet mirë planifikimi i nevojave për prokurim para se të kërkohet dërgesa e çfarëdo malli apo pajisjeve të kërkuara me qëllim të menaxhimit adekuat të buxhetit.	Këtë vit kemi gjendjen pothuajse të njëjtë me përjashtim të vlerës së blerjes së pajisjeve e cila ishte më e vogël.	Pjesërisht i zbatuar

8.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që janë shtuar kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, që menaxhimi dhe raportimi të zbatohet në përputhshmëri me kërkesat ligjore.	Këtë vit kemi evidentim të stoqeve por që gjendja e pasurive tjera ende mbetet e njëjtë dhe nuk ka ndonjë progres.	Pjesërisht i zbatuar
9.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë dhe taksa në biznes, dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.	Nuk janë ndërmarrë veprime nga menaxhmenti.	Nuk është adresuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. Mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që zyrtarët përgjegjës janë duke i kryer detyrat dhe përgjegjësitë në lidhje me faturimin e taksës së biznesit dhe dorëzimin e faturave/aktvendimeve të subjektet afariste.
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës të komunës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave bëjnë rregullimet e gabimeve në bazën e të dhënave për tatim në pronë në pajtim me ligjet dhe rregulloret.
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar të jetë meritore në mënyrë që të jenë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara.
5.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat për blerjen e pajisjeve dhe planifikimi i nevojave për prokurim të jenë analizuar mirë dhe në përputhje me krijimin e parakushteve për funksionalizimin e tyre, duke pasur parasysh gjithnjë vlerën për parandë. Më tutje, duhet të merren masa urgjente që të krijohen parakushtet që pajisjet që gjenden në depo dhe ndërtesat e banimit sociale të futen sa më shpejt në përdorim.
6.	Pasuritë	Kryetari duhet të analizoj arsyet se pse nuk janë kryer veprimet e përcaktuara me vendim dhe të kërkoj përgjegjësi nga zyrtarët përgjegjës të emëruara në ato komisione në lidhje me inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive. Raporti i inventarizimit duhet të përgatitet para hartimit të PFV-ve me qëllim të krahasimeve dhe prezantimit të gjendjes reale të pasurisë komunale.
7.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë dhe taksa në biznes, dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Udhëheqës i Auditimit



Xhevat Seferi, Udhëheqës i ekipit




Faik Thaqi, Anëtar i ekipit



Nebojsa Ristić, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi





LETËR E KONFIRMIMIT


Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Shtërpces, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.



z. Bratislav Nikolić
 Kryetar i Komunës Shtërpce
 Data: 16.06.2021, Shtërpce

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁸ Ky opinion duhet të veçohet nga opinionin nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ [1] Borxhi në 2019 ishte 2,116,653€ kurse në 2020 ka arritur në 2,372,556€.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.